
3XX BLOKU I SHËNIMEVE

LISTA E FUSHAVE

- 300 Shënimi informues
- 305 Shënimi referues në formë teksti "shih edhe"
- 310 Shënimi referues në formë teksti "shih"
- 320 Shënimi me referimin e përgjithshëm shpjegues
- 330 Shënimi i përgjithshëm për qëllimin
- 340 Shënimi për biografinë dhe veprimtarinë
- 356 Shënimi gjeografik

Shënimet në regjistrimet *e njësuara* përdoren për paraqitjen e të dhënave historike të pikëqasjes ose për informacionet shtesë, kur udhëzimet e thjeshta, të cilat gjenerohen nga variantet e pikëqasjeve ose pikëqasjet në lidhshmëri, nuk mund të shpjegojnë mjaftueshëm marrëdhënien midis këtyre pikëqasjeve dhe pikëqasjes së njësuara. Shënimi në regjistrimin *referues* shpjegon marrëdhënien midis pikëqasjes referuese dhe pikëqasjeve të njësuara, të cilave u referohet. Shënimet në regjistrimin *e përgjithshëm shpjegues* shpjegojnë rregullat që përdoren për formimin dhe klasifikimin e atyre pikëqasjeve, të cilat mund të gjenden në formën e dhënë në pikëqasjen shpjeguese.

Shënimet në bllokun 3XX bëhen për përdoruesit dhe janë të shënuara në formën e përshtatshme për paraqitje publike. Shënimet për kataloguesit ndodhen në bllokun e informacionit për burimin e të dhënave 8XX.